



Datë: 17.07.2026

Komisioni i Ankesave, i emëruar në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, sipas Vendimit nr. 3072/26, të datës 06.07.2026, me këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Kadri Sylejmani - kryetar,
2. Prof. Asoc. Dr. Zana Limani – anëtare,
3. Prof. Asst. Dr. Nora Sadiku-Dushi– anëtare,

bazuar në Konkursin Publik me nr. prot. 2/1, të datës 29.06.2026, për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2026/2027, Komisioni, pas shqyrtimit të ankesave, rezultateve preliminare të publikuara, si dhe verifikimit të dosjeve të kandidatëve, paraqet këtë:

R A P O R T

Komisioni ka konstatuar se janë parashtruar gjithsej 14 (katërmëdhjetë) ankesa, prej të cilave: 4 ankesa për programin Elektroenergjetikë dhe Menaxhimi i Energjisë, 8 ankesa për programin Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike dhe 2 ankesa/kërkesa për programin Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit.

Lidhur me ankesat e parashtruara, Komisioni vlerëson si në vijim:

Programi Master: Elektroenergjetikë dhe Menaxhimi i Energjisë

1. ***Eni Sahatqija*** ka paraqitur ankesë për rishikimin e vendimit lidhur me plotësimin e kushteve për aplikim në programin Elektroenergjetikë dhe Menaxhimi i Energjisë. Kandidati ka përfunduar studimet bachelor në programin Mekatronikë. Meqenëse, sipas konkursit, në studimet master kanë pasur të drejtë të aplikojnë vetëm kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (180 ECTS) në programet Elektroenergjetikë, Sistemet Elektroenergjetike dhe Elektroenergjetikë Industriale, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***
2. ***Erijona Rrahmani*** ka paraqitur ankesë për rishikimin e klasifikimit të saj si kandidate që nuk i plotëson kriteret për vlerësim në programin Elektroenergjetikë dhe Menaxhimi i Energjisë. Kandidatja ka përfunduar studimet bachelor në programin Inxhinieri Industriale me Informatikë. Meqenëse, sipas konkursit, në studimet master kanë pasur të drejtë të aplikojnë vetëm kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (180 ECTS) në programet Elektroenergjetikë, Sisteme Elektroenergjetike dhe Elektroenergjetikë Industriale, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***



3. **Besmire Geci** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Rishikimi i testit është realizuar në praninë e Komisionit të Ankesave, me ç'rast kandidatja është pajtuar me vlerësimin. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***
4. **Njomza Krasniqi** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Rishikimi i testit është realizuar në praninë e Komisionit të Pranimet, me ç'rast është konstatuar se kandidates nuk i ishin llogaritur 2 pikë. Kandidatja ishte renditur në vendin e 31-të dhe, pas shtimit të këtyre pikëve, pozita e saj në renditje nuk ndryshon, por mbetet në vendin e 31-të. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e bazuar; megjithatë, shtimi i pikëve nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të renditjes.***

Drejtimi: Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike

5. **Agnesa Rama** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Rishikimi i testit është realizuar në praninë e Komisionit të Ankesave, me ç'rast kandidatja është pajtuar me vlerësimin. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***
6. **Verona Kabashi** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Rishikimi i testit është realizuar në praninë e Komisionit të Ankesave, me ç'rast kandidatja është pajtuar me vlerësimin. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***
7. **Era Maliqi** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Rishikimi i testit është realizuar në praninë e Komisionit të Ankesave, me ç'rast është konstatuar se kandidates nuk i ishin vlerësuar 3 pikë. Pas shtimit të këtyre pikëve, rezultati përfundimtar i saj rritet në 51.4 pikë, ndërsa renditja përmirësohet nga vendi i 70-të në vendin e 66-të. Kandidatja është pajtuar me vlerësimin. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e bazuar; megjithatë, shtimi i pikëve nuk ndryshon rezultatin përfundimtar lidhur me listën e kandidatëve të pranuar.***
8. **Lorika Hajdari** ka parashtruar ankesë lidhur me moslejimin e pjesëmarrjes në provimin pranues për studimet master. Kandidatja është në përfundim të studimeve bachelor në programin Shkenca Kompjuterike në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan. Në momentin e aplikimit, kandidatja kishte të përfunduara 176 ECTS. Meqenëse, sipas konkursit, në këtë program kanë pasur të drejtë të aplikojnë vetëm kandidatët që kanë



përfunduar studimet bachelor me 180 ECTS, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***

9. **Linda Hasanaj** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Rishikimi i testit është realizuar në praninë e Komisionit të Ankesave, me ç'rast kandidatja është pajtuar me vlerësimin. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***
10. **Leutrim Morina** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Rishikimi i testit është realizuar në praninë e Komisionit të Ankesave, me ç'rast kandidati është pajtuar me vlerësimin. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***
11. **Ditjon Thaqi** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Rishikimi i testit është realizuar në praninë e Komisionit të Ankesave, me ç'rast kandidati është pajtuar me vlerësimin. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***
12. **Brela Shala** ka paraqitur ankesë për rishikimin e rezultateve të testit. Kandidatja nuk ka qenë e pranishme gjatë rishikimit të rezultateve. Komisioni i ka verifikuar rezultatet në mungesë të kandidates dhe ka konstatuar se nuk ka pasur asnjë lëshim në vlerësimin dhe evidentimin e pikëve. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se ***ankesa është e pabazuar.***

Programi Master: Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

13. **Shkurtë Mala** ka paraqitur kërkesë që, në rast të mbetjes së vendeve të lira, të pranohet në afatin e dytë. Komisioni rekomandon që kandidatja të paraqitet për informacione shtesë pas përfundimit të afatit të dytë, lidhur me mundësinë e plotësimit të vendeve të rezervuara.
14. **Anjeza Hasanjgjakaj** ka paraqitur kërkesë që, në rast të mbetjes së vendeve të lira, të pranohet në afatin e dytë. Komisioni rekomandon që kandidatja të paraqitet për informacione shtesë pas përfundimit të afatit të dytë, lidhur me mundësinë e plotësimit të vendeve të rezervuara.

1. Prof. Dr. Kadri Sylejmani - kryetar,
2. Prof. Asoc. Dr. Zana Limani – anëtare,
3. Prof. Asst. Dr. Nora Sadiku-Dushi– anëtare,
